



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE			
DRZAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LICNIH PODATAKA			
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA			
ZYRA E ARKIVIT-KANCELARIA ARHIVA-ARCHIVE OFFICE			
Njesia Org.	01	Nr. Prot.	47
Org. Jedin.		Br. Prot.	
Org. Unit		Prot. No:	
Nr. i faqeve	04	Data	
Broj stranica		Datum	30/04/2012
No. pages:		Date:	
PRISHTINË/A			



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
**Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale**  
Drzavna Agencija za Zastitu Licnih Podataka  
National Agency for Protection of Personal Data

<b>DATË/A:</b>	30 PRILL 2012
<b>REFERENC-Ë:</b>	47/2012
<b>PËR/ZA/TO:</b>	z. Sami Kurteshi, Avokat i Popullit
<b>CC:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	z. Ruzhdi Jashari, Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Opinionin e Agjencisë në lidhje me qasjen dhe publikimin e faturave të shpenzimeve të Kryeministrit dhe Zv. Kryeministrave

I nderuar z. Kurteshi,

Në përgjigje të shkresës suaj që e kam pranuar, është kërkuar nga ana juaj një vlerësim i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në lidhje me atë nëse qasja në faturat e shpenzimeve prekë të dhënat personale të ndjeshme dhe privatësinë e Kryeministrit dhe Zëvendëskryeministrave dhe se a mund të publikohen faturat e shpenzimeve të kësaj natyre.

Të bashkangjitur gjeni opinionin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me kërkesën tuaj.

Me respekt,

*Opinion lidhur me qasjen dhe publikimin e faturave të shpenzimeve të Kryeministrit dhe Zëvendëskryeministrave*

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) ka pranuar një kërkesë nga Avokati i Popullit, për të vlerësuar nëse qasja në faturat e shpenzimeve Zyrtarët e Lartë Shtetëror prek të dhëna personale të ndjeshme dhe privatësinë e Kryeministrit dhe zëvendëskryeministrave (Në tekstin e mëtejshëm: Zyrtarët e Lartë Shtetëror), dhe se a mund të publikohen faturat e shpenzimeve të kësaj natyre.

Në Republikën e Kosovës e Drejta e Privatësisë është e drejtë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Marrëveshje dhe instrumente Ndërkombëtare që janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe me dispozitat e neneve 168,169,170,171 dhe 189 të Kodit Penal të Kosovës.

Kjo e drejtë, e garantuar me nenin 36 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përfshin respektimin e jetës private dhe familjare, pacenueshmërinë e banesës, fshehtësinë e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimeve të tjera, dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollat e saj, gjithashtu ka zbatim të drejtpërdrejt në pajtim me nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës garanton që secili person gëzon të drejtën e qasjes në dokumente publike por kufizon qasjen në dokumentet të cilat do të shkelnin privatësinë. Një kufizim i tillë precizohet edhe në Ligjin për qasjen në dokumente publike në nenin 12 (1.6), ku si përjashtim i të drejtës në qasjen e dokumenteve përfshihet privatësia dhe interesat e tjera legjitime private.

Opinionin i Agjencisë është se faturat përmbajnë të dhëna të cilat sipas nenit 2 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale janë të dhëna personale. Këto të dhëna lidhen me mënyrën e jetesës së Zyrtarëve të Lartë Shtetëror, dhe mund të identifikohen përmes këtyre të dhënave. Zyrtarët e Lartë Shtetëror janë fokus i këtyre të dhënave, dhe zbulimi i faturave ndikon drejtpërdrejtë në privatësinë e tyre, kapacitetin e tyre personal ashtu edhe profesional. Publikimi i faturave për shkak të ndjeshmërisë së informacionit të cilët përmbajnë do të shkel privatësinë e Zyrtarëve të Lartë Shtetëror. Zbulimi i këtyre të dhënave do të ishte në kundërshtim me nenin 36 dhe 41 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 12 (1.6) të Ligjit 03/L-215 për qasjen në dokumente zyrtare, me nenin 3 (1), nenin 5 (1.1), nenin 7 (1), nenin 9(2) dhe neni 10 (2) të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Agjencia pranon se ka interes të ligjshëm që të bëhen publike informatat në lidhje me përdorimin e parave publike nga Zyrtarët e Lartë Shtetëror. Por interesi për publikimin e këtyre të dhënave duhet të jetë i balancuar kundruall mbrojtjes së privatësisë dhe të dhënave personale. Ngase faturat mund të përmbajnë të dhëna personale të ndjeshme, si dhe të dhëna të personave të tretë.

E dhënë personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (subjekt i të dhënave); person i identifikueshëm është personi i cili mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në veçanti në bazë të një numri të identifikimit ose të një e më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij ose saj fizik, psikologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror.

Të dhënat të cilat mund të bëjnë të mundur identifikimin e personit mund të jenë;

- Të dhëna për të;
- Të dhëna në lidhje me të;
- Të dhëna të rëndësishme për të;
- Të dhëna të cilat e kanë si fokus atë;
- Të dhëna të cilat mund të kenë çfarëdo ndikimi në lidhje me të.

Faturat përmbajnë të dhëna personale të Zyrtarëve të Lartë Shtetëror, dhe të dhëna të cilat janë të lidhura drejtpërdrejtë me ta. Gjithashtu këto të dhëna mund të jenë mjaft të rëndësishme për ta, ngase kanë si fokus mënyrën e jetesës dhe punës së tyre, dhe zbulimi i këtyre të dhënave mund të ketë ndikim në jetën e tyre private dhe profesionale.

Faturat e ushqimit mund të përmbajnë të dhëna të cilat mund të zbulojnë përkatësinë fetare, apo gjendjen shëndetësore të Zyrtarit apo Zyrtarëve të Lartë Shtetëror. Këto të dhëna janë të dhëna personale të ndjeshme dhe si të tilla në bazë të nenit 7 të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, klasifikohen me qëllim të parandalimit të qasjes dhe përdorimit të paautorizuar. Faturat të cilat mund të përmbajnë të dhëna prej të cilave mund të zbulohen të dhëna personale të ndjeshme janë faturat e drekave dhe darkave zyrtare të Zyrtarëve të Lartë Shtetëror. Këto fatura mund të përmbajnë: Llojin e ushqimit, llojin e pijeve të konsumuara gjatë takimeve zyrtare nga të cilat mund të zbulohet apo prejdhikohet gjendja shëndetësore dhe përkatësia fetare e Zyrtarëve të Lartë Shtetëror të ndërlidhur me faturë, si dhe në të shumtën e rasteve vendet ku mbahen apo janë mbajtur takimet e zyrtarëve të Lartë Shtetëror.

Të dhënat në fatura përmbajnë edhe të dhëna personale të personave të tretë. Zbulimi i këtyre të dhënave është në kundërshtim me nenin 5 (1.1), dhe nenin 10 (2) të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ngase paraprakisht para zbulimit të të dhënave personat e tretë duhet të japin pëlqimin e tij ose saj për përpunimin e të dhënave, dhe duhet të jenë të informuar lidhur me marrësit ose kategoritë e të dhënave të cilat do të zbulohen

Njëkohësisht, zbulimi i të dhënave të personave të tretë, mund të prejudikojë interesa komerciale të ndonjë personi (*Kompani, autoriteti publik apo çfarëdo entiteti legal*).

Të dhënat të cilat i përmbajnë faturat, mund të shërbejnë për kërkime statistikore apo kërkime të tjera, si dhe për profilizimin e personave e që në rastin tonë janë Zyrtarë të Lartë Shtetëror. Përpunimi i këtyre të dhënave për qëllime statistikore apo kërkime të tjera është i mundshëm vetëm nëse subjekti i të dhënave e ka dhënë paraprakisht pëlqimin me shkrim në bazë të nenit 9 (2) të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Që do të thotë se *Zyrtarët e Lartë Shtetëror (dhe personat e tjerë) të ndërlidhur me faturë duhet të japin pëlqimin e tyre për shfrytëzimin e të dhënave për qëllime statistikore apo kërkime tjera.*

Gjithashtu, analizimi i këtyre të dhënave mund të parashikojë preferencat, sjelljen dhe qëndrimin, me një fjalë të bëjë profilizimin e Zyrtarëve të Lartë Shtetëror me të cilët fatura është e ndërlidhur, profilizimi ky i ndaluar sipas rekomandimit të Komisionit Evropian CM/Rec (2010)13.

Të dhënat e personave publik në parim mund të publikohen edhe pa dhënien pëlqimit të personit të ndërlidhur, por të dhënat e publikuara nuk duhet të përmbajnë të dhënat e ndjeshme dhe të dhëna të cilat cenojnë privatësinë, standard ky i rregulluar me nenin 8 dhe 10 (2) të Konventës Evropiane për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Duke e pasur parasysh interesin publik sa i përket njohurisë apo të drejtës për të ditur për shfrytëzimin e parasë publike, të dhënat nga faturat mund të publikohen duke përjashtuar ose anonimizuar të dhënat lartcekura. Në pamundësi të anonimizimit të tyre të krijohet një formular (apo formë e përshtatshme) që do të ofronte transparencën e nevojshme të shpenzimeve të parasë publike.

*Jeta private e personave të njohur ose personave që kryejnë funksione publike duhet të respektohet nëse informacioni apo të dhënat nuk kanë asnjë rëndësi për rolin e tyre ose jetën e tyre publike. Publikimi i faturave tejkalon qëllimin e kërkesës për transparencë të shpenzimeve publike dhe cenon privatësinë e Kryeministrit dhe zv. Kryeministrave.*

Qasja në faturat e shpenzimeve, të cilat përmbajnë të dhëna personale për jetën e personit, është e lejueshme, nëse një gjë e tillë do të ishte në interes të organeve të hetuesisë, me qëllim të zbardhjes së veprave penale të kryera ose veprimeve të kundërligjshme.

Të dhënat personale të subjektit të të dhënave, në mënyrë të veçantë mund të kufizohen me ligj për arsye të: Sigurisë kombëtare, mbrojtjes kombëtare, sigurisë publike, parandalimin e hetimit, zbulimt dhe ndjekjes së veprave penale, ose shkëljes së etikës për profesione të caktuara, interesit të rëndësishëm ekonomik ose financiar të Republikës së Kosovës përfshirë çështjet monetare, buxhetore dhe të taksave, mbrojtjes së subjektit të të dhënave ose të drejtat dhe liritë e të tjerëve.